PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
"PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË BANKAVE",
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.6, DATË 29.1.2003
TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në rregulloren "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave", miratuar me vendimin nr. 6, datë 29.1.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 1 shtohet pika 1.5 me këtë përmbajtje:

1.5 Komiteti i kontrollit të bankës, në bazë të procedurave me shkrim të përgatitura nga banka, bën përzgjedhjen dhe i propozon asamblesë së aksionerëve ekspertin kontabël të autorizuar.

Komiteti i kontrollit bën vlerësimin e raporteve të ekspertit kontabël të autorizuar, të përgatitura sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

2. Në nenin 2 ndryshohet pika 2.3 paragrafi i fundit, me këtë përmbajtje:

Vërtetimin nga autoriteti licencues që vërteton se shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë në fushën e ekspertizës kontabël ose shoqëria ndërkombëtare e auditimit, me të cilën shoqëria e auditimit e krijuar në Shqipëri, e zotëruar (filiale) dhe e kontraktuar prej saj, ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë në fushën e ekspertizës kontabël.

3. Në nenin 3 ndryshon pika 3.3 dhe shtohen pikat 3.4 dhe 3.5 me këtë përmbajtje:

3.3 Miratimi i emërimit të ekspertit kontabël të autorizuar bëhet nga Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes. Refuzimi i emërimit të ekspertit kontabël bëhet nga administratori përgjegjës për Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

3.4 Refuzimi i ekspertit kontabël të autorizuar ndodh edhe në rastin kur Banka e Shqipërisë gjykon se eksperti kontabël i autorizuar, në auditimin e mëparshëm, nuk ka vepruar në përputhje me ose nuk ka plotësuar në mënyrë të mjaftueshme kërkesat e nenit 4, të nenit 5 pika 5.1, të nenit 6 pikat 6.1 deri në 6.4 dhe të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

3.5 Eksperti kontabël i autorizuar dhe/ose banka, në rast refuzimi, kanë të drejtën e ankimimit në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë është përfundimtar.

4. Në nenin 4 ndryshon pika 4.2 me këtë përmbajtje:

4.2 Kontrolli i raporteve financiare, sipas pikës 4.1 të këtij neni, kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit (auditimit).

5. Në nenin 5 ndryshon pika 5.1 me këtë përmbajtje:

5.1 Në bazë të kontrollit që u ka bërë raporteve financiare për vitin ushtrimor, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin përkatës mbi këtë kontroll, të ushtruar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit (auditimit) dhe ia dorëzon këtë raport drejtuesve të bankës dhe komitetit të kontrollit.

6. Në nenin 6 ndryshon pika 6.4 me këtë përmbajtje:

6.4 Eksperti kontabël i autorizuar dorëzon vlerësimin e tij me shkrim tek drejtuesit e bankës dhe te komiteti i kontrollit për pasqyrat financiare të përcaktuara në këtë nen.

7. Në nenin 7 ndryshon pika 7.2 dhe shtohet pika 7.3 me këtë përmbajtje:

7.2 Eksperti kontabël i autorizuar kërkon paraprakisht dhe vlerëson shqetësimet e Bankës së Shqipërisë për aspekte të veçanta të veprimtarisë së bankës.

7.3 Eksperti kontabël i autorizuar përgatit një raport, në të cilin shpreh opinionin dhe vlerësimin e tij mbi rezultatet e nxjerra për organizimin dhe për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të bankës mbi cilësinë e rregulloreve të bankës dhe zbatimin e tyre, të cilin e dorëzon tek drejtuesit e bankës, te komiteti i kontrollit dhe një kopje të tij edhe në Bankën e Shqipërisë, jo më vonë se 6 muaj mbas përfundimit të periudhës raportuese.

8. Në nenin 8 ndryshojnë pikat 8.2 dhe 8.3 me këtë përmbajtje:

8.2 Sipas kërkesës së bërë nga Banka e Shqipërisë, drejtuesit e bankës paraqesin për dijeni në Bankën e Shqipërisë "letrën për administratorët", që eksperti kontabël përgatit për drejtuesit e lartë të bankës. Lëshimi i "letrës për administratorët" është pjesë e letrës së angazhimit.

8.3 Një kopje e raporteve të ekspertit kontabël të autorizuar, të përgatitura sipas kërkesave të neneve 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, së bashku me vlerësimet e komitetit të kontrollit, i dërgohen Bankës së Shqipërisë nga drejtuesit e bankës, jo më vonë se gjashtë muaj mbas përfundimit të periudhës raportuese.

9. Këto ndryshime u miratuan me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, që hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Shkëlqim Cani